

VENDIM
Nr. 562, datë 29.9.2018

**PËR MASAT E PËRSHTATSHME PËR NXITJEN E NJOHJES SË KULTURËS,
HISTORISË, GJUHËS DHE BESIMIT FETAR TË PAKICAVE KOMBËTARE NË
VEPRIMTARINË MËSIMORE DHE SHKENCORE TË INSTITUCIONEVE
TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore e shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit, të përfshijnë në veprimtarinë e tyre mësimore njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore e shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit të përfshijnë, të mbështesin dhe të inkurajojnë realizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore lidhur me njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nëpërmjet aktiviteteve, fushatave sensibilizuese dhe koordinimit me institucionet e arsimit të lartë, promovon njohjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

4. Efektet financiare të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve, fushatave sensibilizuese që do të ndërmerren me nismën e ministrisë përgjegjëse për arsimin, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet financiare të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore e shkencore, të realizuara nga institucionet e arsimit të lartë, do të përballohen nga të ardhurat e vetë institacioneve të arsimit të lartë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**